

URDHËR
Nr. 176, datë 28.7.2023

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Bazuar në nenet 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; në nenin 13 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; në ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; ligjin nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”; në nenin 7 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Apelit të Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar; si edhe në nenin 73 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për procedurat e prokurimit publik, te znj. Laerta Rooze, Sekretar i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
 2. Delegimi i kompetencave mbaron me shfuqizimin e aktit të delegimit.
 3. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm i Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Sokol Çomo